

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.J. nga Prishtina, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2323/2015 të datës 15.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.05.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit A.J., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2323/2015 të datës 15.03.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.2323/2015 të datës 15.03.2018, të akuzuarin A.J. e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK për të cilën gjykata i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind), të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burg, ku një ditë burg do të llogaritet 20 € nga gjoba. I akuzuari, dënimin e shqiptuar mund ta paguajë në dy këste e më së largu deri në datën 5 të muajit vijues e kjo mundësi do të revokohet nëse kësti nuk paguhet me kohë. I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë shumën prej 20,00 në emër të ekspertizës mjeko-ligjore, shumën prej 30€ për programin për kompensimin e viktimave të krimit si dhe në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari Avni Gashi, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar dhe i akuzuari të lirohet nga dënimi me gjobë.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.452/2018 datë 03.05.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit A.J. ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 14.03.2018 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Kolegji penal i kësaj gjykate, bazuar në shkresa të lëndës gjeti se në rastin konkret është shkelë ligji penal në dobi të të akuzuarit, sepse për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe është gjykuar i akuzuari, është paraparë dënim me burg deri në tri vite e jo dënim me gjobë, por duke pasur parasysh se në këtë rast Prokurori kompetent nuk ka ushtruar ankesë, edhe pse dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me dispozitat ligjore, kjo Gjykatë vetëm konstatoi shkeljen e cekur dhe vërtetoi dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë i akuzuari pretendon se rasti ka qenë i nxitur dhe se reagimi i tij ka qenë pasojë e ngarkesës emocionale dhe provokimit direkt të vlerave njerëzore. Duke pasur parasysh faktin se i akuzuari e konsideron veten pre të provokimit psikologjik, ka kërkuar nga kjo Gjykatë që rasti të minimizohet në maksimum dhe mundësisht të lirohet nga dënimi me gjobë duke pasur parasysh se ky rast nuk i përket personalitetit të tij dhe se është i imponuar.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e të akuzuarit për lirimin e tij nga dënimi me gjobë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e sinqertë, se më parë nuk ka qenë i dënuar si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke aplikuar dispozitën e nenit 73 të KPPK, duke vlerësuar faktin se në ankesën e të akuzuarit nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky

dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.444/18 me datë 15.05.2018**

**Zyrtari ligjor**  
**Bujar Ahmeti**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
**1. Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

- 2. Shqipe Qerimi**
- 3. Afrim Shala**